



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
SHOQËRITË HUAMARRËSE NË ADMINISTRIM

Nr. 140 Prot.

Tiranë, më 21 / 08 / 2026

NJOFTIM PËR POZICION VAKANT

Pozicioni: Roje Objekti

Institucioni ynë shpall vakant pozicionin e punës “Roje Objekti”, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbarëvajtjes së aktivitetit në ambientet institucionale.

Përshkrimi i përgjithshëm i detyrës:

Roja e objektit është përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e ambienteve të institucionit, kontrollin e hyrje-daljeve të personave dhe mjeteve, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të perimetrit të objektit. Gjithashtu, siguron respektimin e rregullave të brendshme dhe raporton në kohë çdo situatë të pazakontë apo incident.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Kontrollon hyrje-daljet në objekt dhe verifikon identitetin e vizitorëve;
- Kryen patrullime periodike për të garantuar sigurinë fizike të ambienteve;
- Reagon menjëherë ndaj situatave emergjente dhe njofton strukturat përkatëse;
- Mban regjistrat e hyrje-daljeve dhe raporton çdo parregullsi;
- Zbaton me korrektësi rregulloret dhe procedurat e sigurisë së institucionit.
-

Kriteret e kërkuara:

- Arsim 9-vjecar (preferohet trajnim në fushën e sigurisë);
- Eksperiencë e mëparshme në pozicione të ngjashme përbën avantazh;
- Aftësi të mira komunikimi dhe përgjegjshmëri në punë;
- Integritet dhe korrektësi e lartë profesionale;
- Gatishmëri për të punuar me turne.
-

Dokumentacioni i kërkuar:

- Kërkesë për aplikim;
- Curriculum Vitae (CV);

Adresa: Rruga “Kavajës”, ish Mjetet Mësimore Tiranë, email: info@shha.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- Fotokopje e kartës së identitetit;
- Kopje e diplomës/dëftesës;
- Dëshmi penaliteti;
- Raport mjekësor;
- Dokumente që vërtetojnë eksperiencën e punës (nëse ka).

Afati i aplikimit:

Aplikimet pranohen deri më datë 31.08.2026 .

Mënyra e aplikimit:

Të interesuarit mund të dorëzojnë dokumentacionin pranë zyrave të institucionit ose në adresën elektronike : liridon.cela@shha.gov.al

ADMINISTRATORI

Arben Pregja

